



## **DEKLARATA E TË DREJTAVE**

### **I dorëzohet një personi që është subjekt i një urdhër arresti evropian, i një kërkesë për arrestim paraprak ose ekstradimi**

Ju jeni burgosur nga një gjyqtar i deleguar nga kryetari i gjykatës së apelit pas arrestimit në bazë të një urdhër arresti evropian, të një kërkesë për arrestim paraprak ose ekstradim. Ky dokument përfshin të drejtat kryesore që ju gëzoni.

#### **Ju mund ta ruani këtë dokument gjatë gjithë kohëzgjatjes së qëndrimit tuaj në burg**

#### **Njohja e shkeljes**

Ju keni të drejtë të njihni kualifikimin, datën dhe vendin e kryerjes së veprës penale për të cilat urdhër arresti evropian, kërkesa për arrestim paraprak ose për ekstradim është lëshuar kundër jush.

#### **Asistenca nga një avokat**

Ju mund të kërkontë të asistoheni nga një avokat i zgjedhur prej jush ose i caktuar automatikisht.

Ju jeni i lirë të komunikoni apo të keni korrespondencë me shkrim me avokatin tuaj dhe ky i fundit mund t'ju asistojë në të gjitha marrjet tuaja në pyetje për të cilat ai duhet të lajmërohet. Ai mund të shqyrtojë dosjen tuaj.

#### **E drejta për të ruajtur heshtjen**

Gjatë paraqitjes suaj përpara dhomës së hetimit, ju mund të zgjidhni të jipni deklaratë, t'i përgjigjeni pyetjeve që do t'ju drejtohen ose të heshtni.

#### **Asistenca e përkthyesit**

Nëse ju nuk e flisni apo nuk e kuptoni frëngjishten, keni të drejtën të kërkontë asistencë falas nga një përkthyes gjatë marrjes suaj në pyetje dhe për të komunikuar me avokatin tuaj.

#### **Mundësia për të pranuar dorëzimin tuaj**

Ju keni të drejtën të pranoni ose jo dorëzimin tuaj pranë Shtetit që ju kërkon. Dhoma e hetimit duhet të vendosë në periudhën më të shkurtër kohore në rast pranimit. Nëse ju pranoni dorëzimin tuaj në kuadrin e një urdhër arresti evropian, vendimi juaj nuk do të mund të ndryshohet më vonë.

#### **Kohëzgjatja e heqjes së lirisë dhe e drejta për të kërkuar lirin tuaj**

Kjo kohëzgjatje do të varet nëse ju e keni pranuar ose jo dorëzimin tuaj. Në çdo moment, ju mund t'i kërkontë lirin tuaj dhomës së hetimeve.

#### **Informacion i disa personave**

Ju keni të drejtë të informoni personat që ju dëshironi, dhe sidomos anëtarët e familjes suaj për burgosjen, subjekt i së cilës ju jeni.

Ju gjithashtu mund të informoni autoritetet konsullore të vendit tuaj nëse keni kombësi të huaj.

### **Vizita nga një mjek**

Ju mund të kërkoni të vizitoheni nga një mjek.